- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër

nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1 *Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 12).*

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë

3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 50% e vleres se fondit limit te prokuruar e perkatesisht **39,651,461** (Tridhjetë e nentemilion e gjashtëqind e pesedhjetë e njemije e katerqind e gjashtedhjetë e nje) leke.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese kopje të bilanceve, te certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2017, 2018 dhe 2019.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje vertetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i rregjistruar ne Shqiperi.
4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese një dokument që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron apo ka ushtruar aktivitet për vitet 2018 dhe 2019 (Sipas QKB) sipas percaktimeve ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore per vitin 2019.

2.3 Per kapacitetin teknik:

1. *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë përvojë të suksesshme në ekzekutimin e të paktën:*
 - a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo me te vogel se **39,651,461** (Tridhjetë e nentemilion e gjashtëqind e pesedhjetë e njemije e katerqind e gjashtedhjetë e nje) leke të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit ose
 - b) Punë të ngjashme ku vlera totale e punëve të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit , të jete në një vlerë jo me te vogel se **158,605,842** (Njeqind e pesedhjetë e tetemilion e gjashtëqind e pesemije e teteqind e dyzet e dy) lekë.

Lidhur me këtë pikë ofertuesi të paraqese :

- Formularin e vlerësimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë sipërmarrjet.
- Situacionin përfundimtar.
- Akt-kolaudimin.
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, ofertuesi do ta vërtetojë këtë pune duke paraqitur Formularin e vlerësimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:

- Kontratë sipërmarrje.
- Situacionin përfundimtar.
- Akt kolaudimi objekti.
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit.

2. *Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencë profesionale lëshuar nga organet perkatëse, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1, Niveli A Punime germimi ne toke...

Kategoria NP-2, Niveli B Ndertime civile dhe industriale...

Kategoria NP-3, Niveli A Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile ...

Kategoria NP-7, Niveli A Ujësjiellës,gazsjelles....

Kategoria NP-11, Niveli A Punime per n/stacionet...

Kategoria NP-12, Niveli A Punime te Inxhinierise se Mjedisit

Punime speciale ndertimi:

Kategoria NS-1 Niveli A Punime per prishjen e ndertimeve

Kategoria NS-2, Niveli A Impiante hidrosanitare...

Kategoria NS-8, Niveli A Struktura metalike .

Kategoria NS-14, Niveli A Impiante te brenshme elektrike... .

Kategoria NS-18, Niveli A Punime topogjeodezike

Kategoria NS-19 Niveli A Sistemet kundra zhurmes per infrastrukture

Për Operatorët e huaj të bëhet njësimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucioneve përkatëse shtetërore, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

3. Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas liçencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimi” (Deklarate nga administratori i shoqërisë)
4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për **6(gjashtë) muajt e fundit** duhet të jetë jo më pak se **50 (Pesëdhjetë)**. Këta punonjës nuk duhet të jenë të angazhuar në kontratë/kontrata të tjera si kontraktor apo nëkontraktor për të njëjtën periudhë të zbatimit të kontratës që po prokurohet me Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkoder. (Deklarate nga administratori i shoqërisë)
Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për secilën nga periudhat e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatëse E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.
5. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si Drejtues Teknik të cilet do të

realizojne zbatimin e objektit dhe qe figurojne ne Licencen e Shoqerise si me poshte:

- a. 1 (nje) inxhinier ndërtimi
- b. 1(nje)inxhinier topograf/Gjeodet/Markshaidet/Gjeomatik
- c. 1(nje)inxhinier mjedisi
- d. 1(nje)inxhinier mekanik
- e. 1(nje)inxhinier elektrik
- f. 1(nje) arkitekt

Inxhinierët e mësipërm dhe arkitekti duhet të jenë të siguruar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën 6 (gjashte) muajt e fundit

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës dhe Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

6. *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin një deklaratë nga Administratori i Shoqerise Ofertuese se inxhinieret dhe arkitekti janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.*

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryeje të gjithë verifikimet e nevojshme për te vertetuar deklarinimin e mesiperm.

7. Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jete prezent gjate gjithë kohes ne objekt.

Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar nje mjek te pergjithshem, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, dhe të figurojë në listëpagesa per të paktën 6 (gjashte) muajt e fundit. **Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet ta disponoje mjekun ne varësi të numrit të punonjësve (1-15) që ka marrë përsipër të ofrojë sipas aktmarrëveshjes.**

9. Shoqeria duhet te kete ne personelin e saj **1 (nje) Ekspert Mjedisor**, per hartimin e raporteve te vleresimit dhe ndikimit ne mjedis dhe per te kryer auditimin mjedisor, hartimin e ekspertizave per probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert per te vleresuar nje raport vlersimit te ndikimit ne mjedis ose rezultatet e nje auditimi. Shoqeruar me dokumentacionin perkates ligjoro-profesional, si Diplome, Certifikaten Mjedisore leshuar nga Ministria Mjedisit, kontraten e punes e vlefshme , i cili të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën **6 (gjashte)** muajt e fundit (*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, te pakten njeri prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) Ekspert Mjedisor*).

10. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë nje person që përmbush kriteret për të qenë **Pergjegjes/koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve**, i cili

duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (Pergjegjes/kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, certifikaten e ekspertit, diplomën përkatëse dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për te pakten **6 (gjashte)** muajt e fundit. *(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, te pakten njeri prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) pergjegjes per sigurine).*

11. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (një) “Ekspert per Auditim energjie”** të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për te pakten **6 (gjashte)** muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, certifikaten e ekspertit, diplomën përkatëse. *(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, te pakten njeri prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) Ekspert per Auditim energjie).*
12. Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, nje person te certifikuar per ***Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave***, i cili duhet te figuroje ne listepagese e shoqërisë për te pakten **6 (gjashte)** muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme si dhe dokumentin e perkates te certifikimit.*(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, te pakten njeri prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) nje person te certifikuar per Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave).*
13. Operatori ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, nje person te certifikuar ***Pergjegjes per sigurine dhe higjenen ne kantieret e perkohshme te ndertimit***, i cili duhet te figuroje ne listepagese e shoqërisë për te pakten **6 (gjashte)** muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, si dhe dokumentin e perkates te certifikimit. *(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, te pakten njeri prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) pergjegjes per sigurine dhe higjenen).*
14. Operatori ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, nje person te certifikuar (inxhinier mjedisi ose staf me kualifikim te ngjashëm) si ***Përgjegjës për dëmet në mjedis*** gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet, i cili duhet te figuroje ne listepagese e shoqërisë për te pakten **6 (gjashte)** muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, si dhe dokumentin e perkates te certifikimit *(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, te pakten njeri prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) pergjegjes për dëmet në mjedis).*
15. Operatori ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, nje person te certifikuar ***Pergjegjes per vleresimin e risqeve ne kantier***, i cili duhet te figuroje ne listepagese e shoqërisë për te pakten **6 (gjashte)** muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve:

kontratë pune të vlefshme, si dhe dokumentin e perkates te certifikimit.(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, te pakten njeri prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) pergjegjes per vleresimin e risqeve ne kantier).

16. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B) ose kontrate sherbimi me Shoqeri qe e ofron kete sherbim. (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, te pakten njeri prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë licencen me kodin III.2.B).

17. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën 6 (gjashte) muajt e fundit, te paisur me kontrate pune (te vlefshme), me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:

- 2 (dy) elektrikist
- 2 (dy) saldator
- 2 (dy) teknik (ndërtim, topograf, elektrik, gjeondertim)
- 4 (kater) manovrator
- 2 (dy) pllakashtrues
- 2 (dy) karpentier
- 2 (dy) bojaxhi
- 2 (dy) hidraulik
- 4 (kater) Specialist Ndertimi
- 2 (dy) hekurkthyes
- 2 (dy) punonjes izolimi
- 4 (kater) shofer
- 2 (2) punonjes ne lartesi

Manovratorët duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (eskavatorist) dhe (Automakinist) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit të Transportit Rrugor ndërsa për teknikun e ndertimit duhet të paraqitet diploma e shkolles/deshmi nga organe/institute të akredituar.

18. Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë , duhet të jetë i pajisur dhe të paraqese çertifikatat përkatëse të vlefshme, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”, (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit” (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- BS OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) »(Në rastet e

Dokumenta Standarde të Tenderit

Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

- *PAS 99-2012 mbi « Sistemi i menaxhimit te integruar »(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
- *Çertifikatën per sistemin e menaxhimit te cilesise ne saldim EN- ISO 3834-2:2006 ose ekuivalente me te (e vlefshme). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*
- *ISO 50001-2011 ose ekuivalente me te, e përditesuar (e vlefshme). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

19. Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Lloji i Makinerive	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	Copë 2
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 -10 ton	Copë 1
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	Cope 2
4	Mjete germimi me goma/ fadroma	Copë 1
5	Autovinc	Cope 1
6	Autobetoniere	Cope 1
7	Motogjenerator / Gjenerator	Copë 1
8	Eskavator me zinxhir	Cope 1
9	Saldatrice / motosaldatrice	Cope 1
10	Minieskavator	Cope 1
11	Minifadrome	Cope 1
12	Pajisje per hekurkthyes (tranxhe/elektrobango	Cope 1
13	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	Cope 2
14	Çekic pneumatik per thyerjen e betoneve	Cope 1
15	Kompresor ajri	Cope 1
16	Depozite uji 5000 lt	Cope 1
17	Autorimorkiator mjetesh	Cope 1
18	Autobote uji	Cope 1
19	Pompe uji per pastrim	Cope 1
20	Makineri Prerese hekuri	Cope 1
21	Pompe suvatimi	Cope 1
22	Tokmak per ngjeshje	Cope 1

Dokumenta Standarde të Tenderit

23	Matrapik	Copë 1
24	Vinc ngjites karel	Cope 1
25	Vinc kulle 5 ton	Cope 1
26	Termometer per matje togezimi	Cope 1
27	Skela + rrjete mbrojtes fasade	1000 m2
28	Vibrator betoni	Cope 2
29	Betoniere 0.5m3	Cope 2
30	Saldatrice	Cope 2
31	Instrument nivelues	Cope 1

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Shtojcen nr. 10 te plotesuar.
- ii. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- iii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iv. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës si dhe objekti i ketij prokurimi.
- v. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- vi. Te gjitha mjetet e deklaruar ne kete procedure tenderimi, (sipas shtojces 10) te shoqerohen me fotot përkatëse ku te jete i identifikuar mjete ne fjale (targa etj).**
- vii. Operatori ekonomik ofertues (Administratori i shoqërisë ofertuese), duhet të paraqesë nje deklarate që makineritë e kerkuara ne piken 2.3.10, nuk jane të angazhuara në ndonjë kontratë/kontrata të tjera në fuqi, dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkoder, por vetëm për këtë objekt. Gjithashtu ne deklarate duhet te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera. **Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".****

Periudha e garancise per defektet eshte 2 vjet pas marrjes ne dorezim te objektit (hartimit te procesverbalit te marrjes ne dorezim dhe certifikates)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj: Bashkelidhur Dst

Dokumenta Standarde të Tenderit

Specifikimet Teknike të Materialeve: Bashkelidhur Dst

Grafiku i Punimeve: **12(dymbëdhjete) muaj**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Bashkelidhur Dst

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

**PREVENTIVI
I PUNIMEVE**

Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social, (Rikonstruksion i ish Konviktit te shkollës veterinare)

N.r	Nr. Anal.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi (Leke)	Vlera (Leke)
I PUNIME DHEU						
1	2.30	Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne auto	m³	1,240.00		
2	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m³	1,240.00		
			Shuma I			
II PUNIME MURATURE TULLE						
1	2.71/2	Mur me tulle te lehtesuara t=20cm llaç perzier M25	m³	236.00		
2	2.86	Mur me tulle me 6 vrime, t=12cm, h~3m, llaç perzier M15	m³	147.00		
3	2.121/1	Breza per muret e tulles(12x15 ; 20x15) b/a C - 16/20	m³	23.00		
4	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm per brezat mur tulle	ton	1.10		
			Shuma II			
III PUNIME BETONI DHE B/A						
1	2.262/4b	Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30	m³	505.00		
2	2.117/1b	Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m	m³	67.00		
3	An+2.130/1a	Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 25/30	m³	72.00		
4	An+2.119/1a	Trare e arkitrare b/a C25/30 h ~ 4m	m³	130.00		
5	An+2.122/1a	Soleta te plota b/a C 25/30 t = 20 cm, h ~ 4m	m³	284.00		
			Shuma III			
IV PUNIME HEKUR BETONI						
1	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	50.00		
2	2.167	F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm	ton	75.00		
3	2.182	Konstruksione metalike te thjeshta (kangjella ballkoni dhe shkalle)	ton	1.90		
			Shuma IV			
V PUNIME H/IZOLIMI DHE ÇATIE						
1	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama	m²	860.00		
2	An+2.200	Shtrese lluster cemento 1:3, t = 50 mm	m²	800.00		
3	An+2.283	Shtrese penobetoni t=10 cm , me pjerresi	m²	81.00		
4	2.196/c	Hidroizolim me dy shtresa mapej (ballkone + tualete)	m²	306.00		
5	An+2.423/a	Shtrese plasmasi	m²	820.00		
6	An+2.262/4	Shtrese betoni C 20/25 me perforcues kuarci t=7 cm	m³	56.00		
7	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm per shtresen e betonit Ø8/20 cm	ton	3.17		
8	2.71/2	Mur me tulle te lehtesuara t=20cm llaç perzier M25 , parapeti tarace	m³	20.00		
9	2.121/1	Brez + kolloncina per parapetin e tulles b/a C - 16/20,	m³	9.50		
10	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm per brez+kolloncinat e parapetit	ton	0.65		
			Shuma V			
VI PUNIME SHTRRESASH						
1	2.258	Nenshtrese zhavori (themelet)	m³	201.00		
2	2.262/3	Shtrese betoni C 12/15 (themelet)	m³	65.00		
3	An1+2.262/4	Shtrese betoni C 20/25 (kuota +0.00)	m³	150.00		
4	An+2.264	Shtrese lluster cemento 1:4, trashesi 7cm	m²	1,440.00		
5	2.268/a	Shkalle montazhi mermeri	m²	27.00		
6	2.267/a	Shtrese me pllaka grez porcelanato	m²	1,440.00		
7	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm per shtresen Ø8/15 cm dopio zgare	ton	10.60		
8	2.258	Mbushje zhavori themelet	m³	885.00		
			Shuma VI			
VII PUNIME TAVANIE SUVATIMI						
1	2.300/1	Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me pompe	m²	1,450.00		
2	2.310/1	Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, llaç perzier M 25	m²	4,632.00		
3	2.324a	Plintuse pllake grez	ml	1,595.00		
			Shuma VII			
VIII PUNIME SUVATIMI E VESHJE ME PLLAKA						

Dokumenta Standarde të Tenderit

1	2.326	Veshje me pllake majolike (tualetet)	m ²	480.00	
2	2.334	Suva e zakonshme fasade mur tulle lartesi mbi 8 m	m ²	1,000.00	
3	2.334	Suva kornize dritare me trashesi 2 cm dhe gjeresi 10 cm	m ²	72.00	
		Shuma VIII			
	IX	PUNIME DYER DHE DRITARE			
1	3.375	F V dritare d/alumini me tek xham	m ²	110.00	
2	2.395	F V dyer d/alumini me tek xham	m ²	106.00	
3	An+2.386/2	Dyer te blinduara vendi	m ²	66.00	
4	2.388/1	V F dyer te brendeshme tamburata te rimesuara	m ²	137.00	
		Shuma IX			
	X	PUNIME BOJATISJE			
1	2.404	Boje hidroplastike (lyerje ambientet e brendshme)	m ²	5,600.00	
2	2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e l-re (lyerje e jashtme)	m ²	1,000.00	
3	2.401	Boje vaji siperfaqe metalik	m ²	100.00	
		Shuma X			
	XI	PUNIME TE NDRYSHME DHE PRISHJE			
1	An+2.405	Pragje dritare me pllake mermeri t=3cm	m ²	40.00	
2	2.426/1	Prishje mur tulle me pastrim	m ³	800.00	
3	An-49	Prishje struktura betoni	m ³	300.00	
4	An+2.218	Prishje Çati vendi e zakonshme	m ²	1,102.00	
5	An+2.52/2	Prishje Mur guri themel e xokol	m ³	450.00	
		Shuma XI			
	XII	PUNIME TE JASHTME			
1	2.30	Germim dheu per punimet e sistemimit te sheshit	m ³	180.00	
2	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m ³	180.00	
3	2.114/1	Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m3 C - 16/20	m ³	8.00	
4	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	1.00	
		Shuma XII			
	XIII	PUNIME HIDROSANITARE			
	A	FURNIZIMI ME UJE			
1	2.491/c	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, PN 16	ml	830.00	
2	2.491/e	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, PN 16	ml	20.00	
3	2.491/f	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, PN 16	ml	52.00	
4	An	F V valvol reduktimi presioni	cope	28.00	
5	2.494/3	F.V saracineska bronzi Ø 1 1/4 " = 32 mm	cope	56.00	
6	An	F.V valvol moskthimi Ø 1 1/4 " = 32 mm	cope	28.00	
7	An	F.V saracineske sferë per lavatricen me filter dhe rozete 1/2" x 3/4"	cope	28.00	
8	An	F.V saracineske sferë me filter dhe rozete (LV. Boiler. Bide. WC)	cope	196.00	
9	An	F.V tub flesibel 1/2"	cope	84.00	
10	2.575	Puse kontrolli 1x1x1.5m	cope	1.00	
11	An+2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator	cope	28.00	
12	2.501	F.V WC allafrenga importi	cope	28.00	
13	An+2.506	F.V bide importi porcelani me mishelator	cope	22.00	
14	An - 15	F V bolier 80 liter, uje te ngrohete	cope	28.00	
15	An	F V mishelator dushi	cope	28.00	
16	An	F.V pllake dushi akrilike 80 x 80 harkore	cope	28.00	
		Shuma A			
	B	SHKARKIMI I UJRAVE TE ZEZA			
1	2.523	Tub kanalizimi pvc Ø 200 mm	ml	130.00	
2	An	Tub kanalizimi PP Ø 110 dhe rakorderi	ml	200.00	
3	An	Tub kanalizimi PP Ø 75 dhe rakorderi	ml	236.00	
4	An	Tub kanalizimi PP Ø 50 dhe rakorderi	ml	60.00	
5	2.515	F.V pilete dysHEMEJE Ø 50 mm, tualetet	cope	28.00	
6	An - 19	Pusetete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 100 cm	cope	11.00	
		Shuma B			
	C	SHKARKIMI I UJRAVE TE BARDHA			
1	2.519	Tub kanalizimi pvc Ø 90 mm	ml	15.00	
2	2.523	Tub kanalizimi pvc Ø 200 mm	ml	55.00	
3	An - 23	Pusetete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	cope	3.00	
4	An	Tub kanalizimi PP Ø 75 dhe rakorderi	ml	80.00	
5	An	Tub kanalizimi PP Ø 50 dhe rakorderi	ml	55.00	
6	2.515	F.V pilete dysHEMEJE Ø 50 mm, balkonet	cope	28.00	
7	An	Kanal betoni me zgare metalike te zinguar 2.5 x 15 cm	ml	50.00	
		Shuma C			
		Shuma XIII			
	XIV	PUNIME ELEKTRIKE			
	A	KABINA ELEKTRIKE TM/TU 20/04Kv			
1	An-1	F.V.Box linje 20KV, schneider model IM	kit	2.00	
2	An-2	F.V.Box transformatori 20KV, schneider model QM	kit	1.00	
3	An-3	F.V.Transformator me vaj 20-0,4KV, 630KVA	cope	1.00	

Dokumenta Standarde të Tenderit

3	480/2	FV.Tub flexibel seria rende D=20mm	ml	279.00		
4	2.487	FV.Kuti shperdarese PT-7	cope	1.00		
5	2.487	FV.Kuti shperdarese PT-6	cope	4.00		
6	2.487	FV.Kuti shperdarese PT-4	cope	3.00		
7	2.487/b	FV.Kuti ,suport,kapak muri 3mod	cope	33.00		
8	An-35	FV.RG56 Coaxial kable	ml	22.00		
9	2.481	FV.Percjelles NO7V-K S=1*1mm, k.vededjegies	ml	50.00		
10	2.481/1	FV.Percjelles NO7V-K S=1*1.5mm, k.vededjegies	ml	280.00		
11	2.481/2	FV.Percjelles NO7V-K S=1*2.5mm, k.vededjegies	ml	480.00		
12	2.481/3	FV.Percjelles NO7V-K S=4mm, k.vededjegies	ml	360.00		
13	An-36	F.V.Kabell telefonik J-H(ST)H, 4*0,6mm ²	ml	36.00		
14	An+2.485/3	FV.Celes 1P 10A	cope	6.00		
15	An-38	FV.Celes deviator 1P 10A	cope	4.00		
16	An1+2.485/3	FV.Celes invertitor 10A	cope	1.00		
17	2.485/5	FV.Celes 2P 16A	cope	1.00		
18	An-37	FV.Pulsant 1P 10A	cope	6.00		
19	An+2.485/d	FV.Prize shuko 16A	cope	28.00		
20	An+2.485/a	FV.Prize bivalente 10/16A	cope	12.00		
21	An-39	FV.Tapa fallso	cope	24.00		
22	An-40	FV.Prize rjeti RJ11	cope	3.00		
23	An-41	F.V.Zile elektrike modulare Un=230V	cope	1.00		
24	An-47	FV.Kuader elektrik sipas skemes ne projekt K.2+1 tip	kit	1.00		
25	An-48	F.V.Kornete vidiocitofonie	cope	2.00		
		Shuma per nje apartament 2+1				
		Shuma D(PER 16 AP. 2+1)				
	E	MBROJTJA NGA SHKARKIMET ATMOSFERIKE				
1	An-43	FV.Shufer zingate D=10mm	ml	500.00		
2	2.a-73	FV.Elektroda zingate T 1.5m	cope	40.00		
3	An-44	FV.Shtize rrufepritesi zingate 1.2m	cope	20.00		
4	An-45	FV.Shkeputes togezimi	cope	4.00		
5	An-46	FV.Material montimi rrufepritesi, vida, bulone, staffa, etj	kit	3.00		
6	An-42	F.V.Puseta plastike 30x30x30cm	cope	12.00		
		Shuma E				
		Shuma XIV				
		Shuma pa TVSH				
		Fondi Rezerve 5%				
		Shuma-1				
		TVSH 20 %				
		Shuma me TVSH				

Shtojca 15

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Dokumenta Standarde të Tenderit

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS **Punët – Procedura e Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet

per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.

- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontrakton punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në

kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
